



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Prenjimi: 09. 07. 2024			
Niveli i Studimit: 057 1437			



---

**Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte e Universitetit Publik  
"Kadri Zeka", në Gjilan,**

**shpall këtë:**

**Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor  
në Universitetin "WSG University në  
Bydgoszcz, Poloni**

Universiteti Publik "Kadri Zeka", është pjesë e projektit KA171 ICM, 2022-2027, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e WSG University në Bydgoszcz, Poloni.

Programi Erasmus + KA171 ose Shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve dhe ECTS (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të WSG University në Bydgoszcz nga Polonia dhe Universitetit "Kadri Zeka", në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fusha të ndryshme, ku në këtë thirrje do të kenë mundësi studentët që një semestër ta përfundojnë në Universitetin e Bydgoszcz nga Polonia.

Mundësi aplikimi kanë studentët nga Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të cilët do të kenë përparësi në raport me fakultetet e tjera për shkak të fushës së caktuar të studimit, por edhe studentët e fakulteteve të tjera mund të aplikojnë ku atyre do të ju përshtatet programi studimor në raport me fushën e tyre.

Në këtë thirrje do të pranohen gjithsej dy(2) studentë. Mobiliteti është semestral dhe zgjat minimumi 90ditë, duke filluar nga data 02.10.2024.

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti apo Universiteti pritës.



#### Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.

#### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave;
- CV (në gjuhën angleze);
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim studenti (i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, jo më të vjetër se 30 ditë);
- Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, fotografinë dhe të dhënat personale) ose Letërnjoftimit;
- Certifikata e gjuhës angleze;

Programet e ofruara në këtë mobilitet do të ofrohen në gjuhën angleze dhe si rrjedhojë kërkohet njohja e gjuhës angleze.

1. Studenti duhet të ketë të përfunduar të paktën 2 semestra në programin në të cilin janë regjistruar. Deri në ditën e fundit për aplikim, studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8.00 mund të aplikojnë në program.
- 2). Që studentët të marrin një grant të ICM-se, ata duhet të kalojnë të paktën një semester (3 muaj) në universitetin pritës. Granti i mobilitetit të studenteve të ICM mbulon minimumi 90 dite.
- 3). Studentët që do të marrin pjesë në programet e mobilitetit janë të detyruar të marrin kurse nga universiteti pritës të pakten me vlerë 30 ECTS (rreth 5 kurse).

#### Vlerësimi i aplikantëve:

- Mesatarja e notës: 50%
- Gjuhë e huaj: 50%



## PROCEDURA E APLIKIMIT

- Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike), në mes të datave 09.07.2024 deri 15.07.2024.

Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

- Rezultatet e aplikimit do të shpallen në [www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,

**Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka**  
**Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte**